



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 maj 2020
Nr. ref.:RK 1563/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI241/19

Parashtrues

Sali Krasniqi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kolegjit të
Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje
me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0158-A0018, të datës 17
tetor 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sali Krasniqi nga fshati Zajm i Komunës së Klinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), AC-I-19-0158-A018, të datës 17 tetor 2019, me të cilin është refuzuar kërkesa e tij për revizion e parashtruar kundër aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC –I - 13–0019 - A0018, të datës 15 gusht 2019 dhe Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së), SCC- 08-0287, të 23 janarit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me të cilin pretendohet se shkelën të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 dhjetor 2019, kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 20 janar 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës, për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
8. Më 15 prill 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se kërkesa ka të bëjë me një kontest lidhur me disa parcela tokësore, të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon t'i kishte blerë në vitin 1974, nga personi B. T. Lj, përmes një kontrate gojore. Si rrjedhojë, ndonëse parashtruesi pretendon se kishte përmbushur detyrimin kontraktues ndaj shitësit, e drejta e pronësisë mbi pronat në fjalë nuk është bartur asnjëherë në parashtruesin. Në vitin 1982 parcelat në fjalë ishin eksproprijuar përmes një vendimi të Kuvendit Komunal të Klinës (nga shitësi B. T. Lj) dhe kishin kaluar në pronësi të dy ndërmarrjeve shoqërore.
10. Më datë 24 maj 2005, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Klinë, kundër të paditurës O.SH. OPN "Kosova" në Vushtrri-OBPB "Drini i Bardhë" në Volljak (Klinë), me kërkesën që "mbi bazën e kontratës së shitblerjes e ka fituar të drejtën e pronësisë në njësitë kadastrale nr. 211/3, 213/3 dhe 219/5, në sipërfaqe prej 0.91.71 ha, të regjistruara në fletën poseduese, nr. 179 ZK Novosellë. Paditësi gjithashtu kërkoi që të anulohet vendimi i vitit 1982, i lëshuar nga Kuvendi Komunal në Klinë, Drejtorati për Ekonomi, Punë Komunale, Banesore dhe Pronëso-ro-Juridike, për shpronësimin e parcelave tokësore të cekura më lart.
11. Më 14 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës paraqiti një padi, për të njëjtën çështje, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), ku kërkonte që *"të vërtetohet se ai ishte pronari i ngastrës nr. 221/3, 213/3 dhe 219/5, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0,91,71 ha. Të cilat në listën poseduese kanë qenë të regjistruara si pronë e NSH OPN Kosova, NSH OBPB Drini i Bardhë, dhe NSH Mirusha"* (në tekstin e mëtejme: të Paditurat).
12. Në kërkesëpadinë e tij, parashtruesi i kërkesës deklaroi si bazë ligjore për fitimin e të drejtës pronësore *"se ai kishte fituar të drejtën e pronësisë në bazë të një kontrate të shitblerjes të lidhur në vitin 1974 me ish-pronarin B. T. Lj, por që transferimi i pronësisë tek ai nuk ishte bërë për shkak të taksave të larta dhe ligjit diskriminues të Serbisë. Për më tepër, ai fitoi të drejtën e pronësisë së pronës përmes mbajtjes së saj"*.
13. Agjencia Kosovare e Privatizimi (AKP) parashtroi përgjigje në padinë e parashtruesit të kërkesës, në të cilën theksoi se nuk kishte prova me të cilat dëshmohet shitja e pronës në fjalë dhe se kontrata e paraqitur për shitjen e pronës së kontestuar nuk ishte lidhur me shkrim, siç kërkohet nga neni 9 i Ligjit për transaksionet e tokave dhe ndërtesat (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 43/65).
14. Me 23 janar 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori aktgjykimin SCC - 08 - 0287, me të cilin e hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar se:

„Gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka vërtetuar se ai ka fituar pronësinë e ngastrave të pretenduara kadastrale me nr. 211/3, 213/3 dhe 219/5, me sipërfaqe prej gjithsej 0.91,71 ha, ZK Novosellë e Zajmit, pasi që kontrata nuk është lidhur me shkrim dhe prandaj çdo kontratë e lidhur

gojarisht është nule dhe e pavlefshme. Prandaj Gjykata ka refuzuar padinë si të pabazuar“

“Paditësi nuk mund të kërkojë pronësinë nëpërmjet parashkrimit fitues pasi që paditësi nuk mund të konsiderohet së është në mirëbesim gjatë këtij përvetësimi për dy arsye: së pari, ai është dashur të dijë se forma me shkrim është kusht i obligueshëm për transferimin e pronës së patundshme pasi që ky ka qenë një fakt i zakonshëm dhe i njohur mirë. Së dyti, paditësi ka qenë në dijeni për këtë meqë arsyet për mos lidhjen e kontratës me shkrim kanë qenë ‘taksat e larta dhe ligji diskriminues i Serbisë’ ashtu siç ai ka theksuar në padinë e tij të parashtruar në gjykatë më 14 nëntor 2008“.

15. Parashtruesi i kërkesës i paraqiti ankesë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, kundër aktgjykimit SCC-08-0287 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, ku pretendonte vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit.
16. Më 15 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin AC-I-13 - 0019-A0018, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (SCC-08-0287).
17. Në këtë Aktgjykim, Kolegji i Apelit i DHPJS-së, ndër të tjera, arsyetoi se: *“Në rastin konkret, kontrata për transferimin e pronës është lidhur vetëm gojarisht ndërmjet paditësit dhe B. T.Lj në vitin 1974. Neni 9 i Ligjit mbi Transaksionet e Tokave dhe Ndërtesave (GZ-RSFJ nr. 43/65), që ishte në zbatim në atë periudhë kohore, në mënyrë eksplicite kërkon një formë më shkrim për transferimin e tokës, ndryshe kontrata nuk do të prodhojë asnjë efekt juridik. [...] Gjithashtu paditësi nuk mund të fitojë pronësinë në ngastrat e lartëpërmendura nëpërmjet parashkrimit fitues, sepse paditësi nuk mund të konsiderohet se është me mirëbesim [...]”.*
18. Kundër Aktgjykimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës i paraqiti një kërkesë për revizion Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ku deklaronte se Kolegji i Apelit ka për detyrim që, nëse konstaton se gjatë procedurës gjyqësore ka ardhur deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, në përputhje me nenin 14, paragrafi 2, të Ligjit 04/L-033 për Dhomën e Posaçme, përsëri të shqyrtoj faktet me ç’rast do të zbatojë *“mutatis mutandis dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore“.*
19. Më 17 tetor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori vendimin AC-I-19-0158-A0018, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit për shqyrtim si të papranueshme, me arsyetimin se: *“Palët, në bazë të nenit 9. 15 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, nuk kanë në dispozicion të tyre mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike për të kundërshtuar vendimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit“.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me vendimet e tyre gjyqësore, duke mos njohur të drejtën pronësore të paditësit mbi patundshmërinë kontestuese që e ai fitoi përmes kontratës së shitblerjes së vitit 1974, shkelën nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së”.
21. Në këtë vazhdë, parashtruesi i kërkesës pohon se ai kishte lidhur një marrëveshje gojore me pronarin e atëhershëm të pronës kontestuese dhe se kishte përmbushur detyrimet kontraktues, duke paguar shumën e plotë të të hollave për të cilat ata ishin pajtuar me kontratë. Mirëpo, në vitin 1982 erdhi deri tek shpronësimi i asaj prone, e cila më pas është regjistruar në librat kadastralë si pronë e “NSH OPN Kosova“, ”NSH OBPB Drini i Bardhë“, dhe ”NSH Mirusha“. Parashtruesi më tutje argumenton se edhe pse në kuptimin formalo-juridik ishte kryer procesi i eksproprijimit, ai kishte mbetur posedues faktik i papenguar i parcelave në fjalë.
22. Parashtruesi argumenton se vet shitësi (ish pronari) i parcelave në fjalë (personi B.T. Lj), në seancën e mbajtur në Kuvendin Komunal në Klinë, në vitin 1982, kishte pohuar se parcelat të cilat po eksproprijoheshin ia kishte shitur parashtruesit në vitin 1974, por për këtë nuk kishin bërë kontratë me shkrim dhe as vërtetim të saj në gjykatë. Parashtruesi i kërkesës ka bashkangjitur një dokument nga seanca në fjalë, e mbajtur në vitin 1982 në Kuvendin Komunal në Klinë, në mbështetje të pretendimit të tij se B. T. Lj., kishte pranuar se i kishte shitur parcelat në fjalë parashtruesit të kërkesës dhe së detyrimet kontraktuese ishin përmbushur nga të dyja palët.
23. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *“[...] shitësit, si ish pronarë, nuk i ishte dorëzuar asnjëherë aktvendimi i Kuvendit Komunal në Klinë [...] i vitit 1982 për eksproprijimin e paluajtshmërisë kontestuese [...] dhe se as ish pronarit B.T. Lj e as Sali Krasniqit si blerës nuk i ishte bërë kurrfar kompenzimi-shpërblimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar [...]”*.
24. Më tutje, parashtruesi i kërkesës deklaron se, në kuptim të nenit 20, paragrafi 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP), në lidhje me nenet 73, 11 dhe 12 të LMD-së, ai ka një bazë ligjore për fitimin e pronësisë dhe me vetë këtë ai ka legjitimitetin që në procedurën gjyqësore kundër të paditurave të kërkojë njohjen e të drejtave pronësore mbi pronën kontestuese.
25. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me një kërkesë që të pranojë kërkesën si të bazuar dhe të anulojë aktgjykimet e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

29. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjyqimit ose vendimit të kontestuar.

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit”.

30. Në dritën e kësaj, Gjykata fillimisht vë në dukje pretendimin thelbësor të parashtruesit të kërkesës, se vendimet e dy shkallëve (kolegjeve) të DHPGJS-së, të cilat nuk kanë njohur të drejtat pronësore të parashtruesit mbi patundshmërinë kontestuese, kanë shkelur nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së“.
31. Gjykata vëren se, lidhur me çështjen në fjalë, parashtruesi i kërkesës fillimisht kishte ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Klinë. Nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se cili ka qenë epilogu i kësaj padie (të ushtruar në Gjykatën Komunale në Klinë). Për më tepër, parashtruesi në kërkesë nuk ka çekur asnjë pretendim lidhur me këtë procedurë. Duke marrë parasysh këto fakte, Gjykata konkludon se nuk do të merret më këtë pjesë të procedurës.
32. Gjykata poashtu vëren se në DHPGJS është zhvilluar procedura mbi meritat e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, ku gjithashtu u trajtua çështja e pronës në fjalë. Gjykata konstaton se ajo procedurë gjyqësore është përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit, AC -I -13-0019 - A0018, të datës 15 gusht 2019.
33. Gjykata gjithashtu vë në dukje se parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë për revizion në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, pikërisht kundër aktgjyqimit të formës së prerë, të nxjerrë nga Kolegji i Apelit më 15 gusht 2019.
34. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-19-0158-A0018, të datës 17 tetor 2019, të nxjerrë sipas kërkesës për revizion të parashtruesit të kërkesës, ku u konstatua se *“në bazë të nenit 10 paragrafi 14 i Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme [...], të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër, përkatësisht se palët, në procedurë, në bazë të nenit 9. 15 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, nuk kanë në dispozicion të tyre mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike për të kundërshtuar vendimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit“.*
35. Gjykata vëren se në Aktvendimin e lartcekur, Kolegji i Apelit i DHPGJS referohet edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, në raste të ngjashme, gjegjësisht në rastet: KI 103/12; Ki 57/13; Ki 23/14.
36. Në këtë drejtim, Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore, ku ka përcaktuar se: *“Është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese”* (shih: vendimin në rastin KI02/15, Parashtrues i kërkesës: Qendra Shoqërore, Kulture, Sportive, Ekonomike “Pallati i Rinisë”, Aktvendim për papranueshmëri i 18 majit 2015, paragrafi 29).

37. Gjykata rikujton se pas pranimit të aktgjykimit AC-I-13-0019-A0018, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, të 15 gushtit 2019, parashtruesin e kërkesës nuk e ka penguar asgjë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Sidoqoftë, ai përdori mjetin juridik në formën e revizionit, i cili, si i tillë, nuk parashihej me ligj.
38. Prandaj, Gjykata konstaton se “vendimi i fundit” në rastin konkret, në përputhje me nenin 49 të Ligjit, është Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-13-019-A0018, i datës 15 gusht 2019, me të cilin është hedhur poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-08-0287, të 23 janarit 2013. Rrjedhimisht, ky Aktgjykim përbën një vendim të formës së prerë kundër të cilit nuk mund të parashtrohet ankesë, revizion ose ndonjë mjet tjetër juridik (shih edhe rastin e Gjykatës KI120/17, parashtrues i kërkesës *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 dhjetorit 2017, dhe *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, vendim i 5 janarit 2006).
39. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-13-0019-A0018, i 15 gushtit 2019, sipas deklarimeve të parashtruesit të kërkesës, i është dorëzuar atij më 20 gusht 2019, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është parashtruar me 26 dhjetor 2019. Nga kjo mund të konstatohet se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur jashtë afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
40. Gjykata rikujton se afati procedural fillon nga “vendimi i fundit” në procedurën e shterjes së mjeteve juridike, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës (shih vendimi i 14 marsit 2002, shih edhe rastin e Gjykatës KI120/17, parashtrues i kërkesës *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 dhjetorit 2017, shih *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, vendim i 5 janarit 2006).
41. Gjykata gjithashtu rikujton praktikën e saj në rastet e ngjashme, që është në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas të cilës parashtruesi i kërkesës duhet të shterojë mjetet juridike të cilat pritet të jenë të lejuara dhe efektive. Vetëm mjetet juridike efektive mund të merren në konsideratë nga Gjykata. Parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe Rregullore të punës, duke përdorur mjete juridike që nuk janë të parapara në procedurën në lidhje me çështjen në fjalë (shih: vendimi i 5 janarit 2006; shih edhe rastin e Gjykatës KI120/17, parashtrues i kërkesës *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 dhjetorit 2017, shih *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04).
42. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I - 13-0019 - A0018, u dorëzua pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
43. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih edhe rastin e Gjykatës

Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24, shih: vendimin e GJEDNJ-së për pranueshmëri, në rastin *Çelik kundër Turqisë*, kërkesa nr. 52991/99, të 23 shtatorit 2004).

44. Gjykata i referohet edhe argumenteve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me (mos)kompensimin për shpronësimin e pronës kontestuese, si dhe mos vënien në dispozicion të tij dhe të ish-pronarit të pronës së kontestuar, të Aktvendimit të Komunës së Klinës, me të cilin ishte bërë shpronësimi në fjalë (në vitin 1982).
45. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte ngritur para gjykatave të rregullta, përkatësisht DHPGJS-së, çështjen e shpronësimit, kështu duke mos iu dhënë mundësi gjykatave të rregullta të adresojnë këtë çështje.
46. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë këtë çështje (këtë pretendim) pa qenë paraprakisht e ngritur dhe e vlerësuar në procedurë pranë gjykatave të rregullta. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë (shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KI 41/19; KI24/16; KI89/15; KI139/12; KIo7/09).
47. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa nuk plotëson kushtet procedurale të pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39.1 (b) dhe (c) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, neneve 20.47.2 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39.1 (b) dhe (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi